



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 827 Prot.

Kuçovë, më 09.032023

VENDIM

Nr. 09 datë 27.02.2023

“Mbi Miratimin e Kritereve te Dhenies se Ndhimes Ekonomike nga Fond i Kushtezuar per Bllok-Ndihmen Ekonomike deri ne 6% dhe/ose me Fonde te Buxhetit Vendor.”

Keshilli I Bashkise në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”, nenit 21 të ligjit nr.57/2019 “Për Asistencen Sociale ne Republikën e Shqiperise” kreu IV, pika 1 dhe 2 e VKM-se nr 597, date 04.09.2019” Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e Kushtezuar per ndihmen ekonomike” “, Udhëzimit nr.5 dt.17.02.2017” Titulli I ndryshuar “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind” I ndryshuar me propozim te Drejtorise se Shërbimit Social,

VENDOSI:

1. Te miratoje kriteret per dhenien e ndihmes ekonomike nga fondi shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike I cili eshte 6% e ketij fondi dhe mbi kete fond mund te shtohen ose jo edhe fondet e buxhetit vendor.

2. Kriteret sipas pikes numer 1 te ketij projekt-vendimi jane si me poshte :

- a) Familje te varfra te cilat nuk jane shpallur perfituese nga sistemi I pikezimit.
- b) Familje me krye familjare gra qe jane te ve ,te divorcuara, vajze nene ne veshtiresi ekonomike dhe sociale.
- c) Persona te pa afte ,te vetmuar te cilet nuk kane asnje burim te ardhurash.
- d) Familje me femije ne risk, referuar nga Njesia e Mbrojtjes se Femijve .